Në bazë të propozimit të Kryetarit të Komunës së Deçanit, të dt.20.06.2025, nr.01-15084, për ndarjen e një hapësire (parcelë e cila është pronë komunale) për ndërtimin e një objekti për nevojat e Shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së, dega në Deçan, në pajtim me dispozitat e nenit 10, 11 dhe 15 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenin 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), në bazë të nenit 22 dhe 26 pika 7 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, duke u bazuar në Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) 2024-2032 01.Nr.I-8, të dt.27.02.2025, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.27.06.2025, miratoi këtë:

# V E N D I M

## PËR NDARJEN E PARCELËS PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT PËR NEVOJAT E SHOQATAVE TË DALA NGA LUFTA E UÇK-së DEGA NË DEÇAN

I.

Miratohet Vendimi për ndarjen e parcelës për ndërtimin e Objektit për nevojat e Shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së, dega në Deçan.

II.

Parcelat e caktuara për ndërtimin e Objektit për nevojat e Shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së, dega në Deçan janë:

1. Parcela Nr.01018-0 me sipërfaqe S=241 $m^2$ - Njësia Kadastrale P-70505021-01018-0.
2. Parcela Nr.01020-0 me sipërfaqe S=737 $m^2$--Njësia Kadastrale P-70505021-01020-0.
3. Pjesë nga Parcela Nr.01021-1 me sipërfaqe S=322 $m^2$,-Njësia Kadastrale P-70505021-01021-1.
4. Parcela Nr.01019-0 me sipërfaqe S=161 $m^2$,-Njësia Kadastrale P-70505021-01019-0.

**Sipërfaqja e përgjithshme është S=1461 $m^2$.**

Zona Kadastrale Deçan, pronar Komuna e Deçanit, si dhe është në harmoni me Dokumentin e planifikimit hapësinorë të Komunës së Deçanit "Plani Zhvillimor Komunal-PZHK 2024-2032", 01.Nr.I-8, të dt.27.02.2025, parcela të planifikuara në PZHK për ndërtim, brenda Zonës Urbane.

III.

Për zbatimin e këtij Vendimi do ta kujdesen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinorë dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër e Komunës së Deçanit.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

K.K. DEÇAN.AS 16373
01 02.07.25

Në bazë të Qarkores Buxhetore 2026/01 të Ministrisë për Financa të dt.15 Maj 2025, në bazë të nenit 40.2 shkronja (b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), nenit 26 pika 2. të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.27.06.2025, miraton këtë:

# V E N D I M

## PËR APROVIMIN E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE (KAB) PËR KOMUNËN E DEÇANIT PËR VITET 2026-2028

I.

Aprovohet Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) për Komunën e Deçanit për vitet 2026-2028.

-Buxheti i planifikuar sipas Qarkores buxhetore 2026/01, për vitin 2026 është – 14,551,974.00€ (13,583,695.00€ nga grantet dhe 968,279.00€ nga të hyrat vetanake)

-Buxheti i planifikuar sipas Qarkores buxhetore 2026/01, për vitin 2027 është – 14,413,973.00€ (13,367,806.00€ nga grantet dhe 1.046,167.00€ nga të hyrat vetanake)

-Buxheti i planifikuar sipas Qarkores buxhetore 2026/01, për vitin 2028 është – 13,530,758.00€ (12,478,732.00€ nga grantet dhe 1,052,026.00€ nga të hyrat vetanake)

II.

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) për Komunën e Deçanit për vitet 2026-2028.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

IV.

Me Vendim njoftohen: MF-Departamenti i Buxhetit, Zyra e Kryetarit, Drejtoritë komunale dhe Arkivi i Komunës.

**01.Nr. V- 2 ,**
**Deçan,dt.27.06.2025**

KK DEÇAN 15806
01 30.06.25

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Hajdar SUTAJ**

Në bazë të nenit 12, paragrafi, 12.2 shkronja (c) të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), - në bazë të Ligjit Nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina, në bazë të nenit 17 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për administratë të hapur në Komunë, në bazë të dispozitave të Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, në bazë të nenit 26 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.27.06.2025, merr këtë:

# V E N D I M

PËR MIRATIMIN NË PARIM PËR VËNIE NË KONSULTIM PUBLIK TË DRAFT – PLANIT NDËRKOMUNAL PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETURINAVE (PNMIM) PËR PESË KOMUNAT E RAJONIT TË DUKAGJINIT: PEJË, KLINË, ISTOG, DEÇAN DHE JUNIK 2025 – 2035

I.

Kuvendi i Komunës së Deçanit merr vendim për miratimin në parim për vënie në Konsultim Publik të Draft- Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) për pesë komunat e rajonit të Dukagjinit: Pejë, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik 2025 – 2035.

II.

Konsultimi publik zgjatë 30 ditë, duke filluar nga data 30.06.2025, në të cilën Drejtoria për Shërbime Publike në koordinim me Zyrën për Informim mund të organizojnë diskutime/konsultime të ndryshme me palët e interesuara për këtë Draft-Rregullore, ndërsa Debati i përgjithshëm publik me qytetarë do të mbahet me dt.16.07.2025, duke filluar nga ora 11:00, në Sallën e Kuvendit kati i I-rë në objektin e Komunës.

III.

Pyetjet, vërejtjet, sugjerimet dhe komentet mund të drejtohen çdo ditë në Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Zyrën për Informim.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Shërbime Publike.

V.

Vendimi hyn në fuqi 15(pesëmbëdhjetë) dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës në gjuhët zyrtare.

01.Nr.V-4
Deçan,dt.27.06.2025

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

K.K Deçan AS 16372
01 02.07.25

Në bazë të nenit 12, paragrafi, 12.2 shkronja (c) të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), - nenit 2 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura si dhe Rregullores (QRK) numër nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, në bazë të nenit 17 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për administratë të hapur në Komunë, në bazë të Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, në bazë të nenit 26 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.27.06.2025, merr këtë:

# VENDIM

PËR MIRATIMIN NË PARIM PËR VËNIE NË KONSULTIM PUBLIK TË DRAFT – RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË ADMINISTRATËN KOMUNALE

I.

Kuvendi i Komunës së Deçanit merr vendim për miratimin në parim për vënie në Konsultim Publik të Draft- RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË ADMINISTRATËN KOMUNALE.

II.

Konsultimi publik zgjatë 30 ditë, duke filluar nga data 30.06.2025, në të cilën Zyra e Kryetarit në koordinim me Zyrën për Punë të Kuvendit, Zyrën e Personelit dhe Zyrën për Informim mund të organizojnë diskutime/konsultime të ndryshme me palët e interesuara për këtë Draft-Rregullore, ndërsa Debati i përgjithshëm publik me qytetarë do të mbahet me dt.17.07.2025, duke filluar nga ora 14:00, në Sallën e Kuvendit kati i I-rë në objektin e Komunës.

III.

Pyetjet, vërejtjet, sugjerimet dhe komentet mund të drejtohen te Zyra e Kryetarit, Zyra për Punë të Kuvendit, Zyra e Personelit dhe Zyra për Informim.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës.

V.

Vendimi hyn në fuqi 15(pesëmbëdhjetë) dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës në gjuhët zyrtare.

01.Nr.V-6
Deçan,dt.27.06.2025

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

K.K. DEÇANAS. 16375
01 02.07.25

Me kërkesën e Drejtorisë për BPZHR, për ndarjen e mjeteve financiare për kryerjen e obligimeve ndaj Marrëveshjes së Komunës së Deçanit me Kompaninë Rajonale të Ujitjes (KRU) "Drini i Bardhë" SH.A. me seli në Pejë, Marrëveshja Nr.02-13375, dt.03.06.2025, participim i komunës në vlerë prej 11,500.00 euro në projektin e përbashkët për pastrimin sezonal të kanaleve të ujitjes në territorin e Komunës së Deçanit, në bazë të nenit 17 dhe nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), si dhe nenit 26 pika 2. të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.27.06.2025, merr këtë:

# V E N D I M

## PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE SI PARTICIPIM ME KOMPANINË RAJONALE TË UJITJES (KRU) "DRINI I BARDHË" SH.A. PEJË NË PROJEKTIN E PËRBASHKËT PËR PASTRIMIN SEZONAL TË KANALEVE TË UJITJES NË TERRITORIN E KOMUNËS SË DEÇANIT

**I.** Aprovohen mjetet financiare për kryerjen e obligimeve ndaj Marrëveshjes së Komunës së Deçanit me Kompaninë Rajonale të Ujitjes (KRU) "Drini i Bardhë" SH.A. me seli në Pejë, Marrëveshja Nr.02-13375, dt.03.06.2025, participim i komunës në projektin e përbashkët për pastrimin sezonal të kanaleve të ujitjes në territorin e Komunës së Deçanit në shumën totale 11,500.00 € ( Me fjalë:njëmbëdhjetmijepesëqindeuro).
Sipas marrëveshjes mjetet finaciare do të transferohen në xhirollogarinë e Kompaninë Rajonale të Ujitjes (KRU) "Drini i Bardhë" SH.A. me seli në Pejë.

II. Mjetet financiare, si në pikën I. të këtij vendimi ndahen nga linja buxhetore e Zyrës së Kryetarit ose Drejtoria për Buxhet dhe Financa, nga kategoria e subvencioneve.

III. Për realizimin e këtij vendimi do të kujdesen:Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa e KK Deçan.

IV. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe 7 dit pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

V. Me vendim njoftohen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për BPZHR, Kompania Rajonale të Ujitjes (KRU) "Drini i Bardhë" SH.A-Pejë, dhe Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.V-8
Deçan, dt.27.06.2025

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

K.K Deçan AS 16374
01 02.07.25

V.

Pjesë përbërse të këtij vendimi janë :

- Skica grafike,
- Kopjet e planit dhe
- Certifikata e njësisë kadastrale.

VI.

Vendimi iu dërgohet : Kryetarit të Komunës, z.Bashkim Ramosaj, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinorë, Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Arhivit të Komunës së Deçanit.

01.Nr.V-5
Deçan,dt.27.06.2025

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

| | |
|---|---|
| Për/To/Za : | Kuvendin e Komunës së Deçanit<br><br>Komitetin për Politikë dhe Financa |
| Nga/From/Od | z.Bashkim Ramosaj– Kryetar i Komunes |
| Tema/Subject/Subjekat | Propozim vendim për ndarjen e një hapësire për ndërtimin e objektit për nevoja të Shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së, dega në Deçan; |

Të nderuar ,

I. Me këtë propozim i kërkoj Kuvendit të Komunës së Deçanit që konform ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës të merr Vendim për ndarjen e një hapësire për ndërtimin e objektit për nevoja të Shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së, dega në Deçan;

Hapësira e propozuar për ndërtimin e objektit për nevoja të Shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së, dega në Deçan, është parcela nr.01018-0 me sipërfaqe 241 $m^2$, parcela nr.01020-0 me sipërfaqe 737 $m^2$ , parcela nr.01019-0 me sipërfaqe 161 $m^2$, si dhe një pjesë nga parcela 01021-0, Zona Kadastrale Deçan

Propozimi i dërgohet KPF-së dhe Kuvendit të Komunës së Deçanit për shqyrtim dhe marrje të vendimit.

Me respekt,

Deçan, dt.20.06.2025

ZKRYETARI 15084
01 20.06.25

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

***Qeveria - Vlada - Government***

***Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure***

**AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY**

# EKSTRAKT NGA CERTIFIKATA / IZVOD IZ CERTIFIKATA / EXTRACT OF CERTIFICATE

## PERSONI / OSOBA /PERSON : Komuna e Deçanit

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | **12-zyrtarisht-2025** |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 20.06.2025 - 10:26 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | DEÇAN / DEČANE / DEÇAN |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | DEÇAN / DEČANE / DEÇAN |

## A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

| Mbiemri/Emri i afarizmit (biznesit)<br>Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa)<br>Last Name / Business Name | Emri<br>Ime<br>First Name | Emri i babait<br>Ime oca<br>Father's Name | Gjinia<br>Pol<br>Gender | Nr. personal/ biznesit<br>Lićni broj/broj poslovanja<br>ID. No. | Shteti i shtetësisë apo regjistrimit Država državljanstva ili uknjiženja<br>Country ofcitizenship | Ditëlindja/Data e themelimit<br>Rodendan/Dan osnivanja<br>Date of Birth/Establishment | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Komuna e Deçanit | | | /<br>/ | **600325668** | KOSOVA /<br>KOSOVA /<br>KOSOVO | | 29.12.2020 | |

## A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

| Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address Details | Adresa tjetër<br>Druga adresa<br>Other address | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| /<br>/ | | JASHAR SALIHU | | |

## B. NJESIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT

| Njësia kadastrale Katastarska jedinica Cadastral unit | Komuna / Opština / Municipality | Zona kadastrale Katastarska zona Cadastral zone | Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit type | Tipi i pronës Tip imovine Property Type / Lloji i pronës Vrsta imovine Property kind | Kati/ Katet Br.Sprata/ Spratova Floor number | Vendi i quajtur Zvano mesto Place name | Sipërfaqja Površina Area | Shfrytezimi aktual/Kultura-klasa Aktuelna upotreba/ Kultura-klasa Actual use/Culture-class | Pjesa e pronës Deo imovine Share quota | Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-70505021-01018-0 | DEÇAN / DEČANE / DEÇAN | Deçan / Deçan / Deçan | PARCELË / PARCELA / parcel | Pronë shoqërore Drushtvena Imovina Socially owned Land / | | PODI / PODI / PODI | 241 | Bujqësore - Arat - Arë E Klasës 4 / / Poljoprivredno - Njive - Njiva 4 Klase / / Agriculture - Arable - 4th Class Arable Land / / | 1 / 1 | Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | |
| P-70505021-01019-0 | DEÇAN / DEČANE / DEÇAN | Deçan / Deçan / Deçan | PARCELË / PARCELA / parcel | Pronë shoqërore Drushtvena Imovina Socially owned Land / | | PODI / PODI / PODI | 161 | Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 3 / / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pasnjak 3 Klase / / Agriculture - pasture - 3rd Class Pasture / / | 1 / 1 | Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | |
| P-70505021-01020-0 | DEÇAN / DEČANE / DEÇAN | Deçan / Deçan / Deçan | PARCELË / PARCELA / parcel | Pronë shoqërore Drushtvena Imovina Socially owned Land / | | PODI / PODI / PODI | 737 | Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 3 / / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pasnjak 3 Klase / / Agriculture - pasture - 3rd Class Pasture / / | 1 / 1 | Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | |
| P-70505021-01021-1 | DEÇAN / DEČANE / DEÇAN | Deçan / Deçan / Deçan | PARCELË / PARCELA / parcel | Pronë shoqërore Drushtvena Imovina Socially owned Land / U | | PODI / PODI / PODI | 12976 | Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 3 / / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pasnjak 3 Klase / / Agriculture - pasture - 3rd Class Pasture / / | 1 / 1 | Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | 03.10.2017 |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

# KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : DEÇAN

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Deçan

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-70505021-09003-0 | | |
| P-70505021-01018-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 241 |
| P-70505021-01020-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 737 |
| P-70505021-01021-1 | Parcelë / Parcela / Parcel | 12976 |
| P-70505021-01019-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 161 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:2271

Punoi/Obradio/Created: Elezaj

Nënshkrimi/Potpis/Signature: _____

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 20.06.2025

Koha/ Vreme/ Time: 10:26:45

Shqip | Srpski | English LOGOHU

FILLIMI KËRKO DHE PARAQIT

Kërko

1 : 500 Auto Shfaq kështillat

Lista e shtresës Ndihma

- Ortofoto
  - Orthophoto2024Rural
  - Orthophoto2024Urban
  - Orthophoto2018Rural
  - Orthophoto2018Malore
  - Orthophoto2018Urban
  - Ortofoto 2015 UAV
  - Ortofoto 2012
  - Ortofoto 2009
  - Ortofoto 2004
- Hartat Topografike
  - Harta Topografike 1:250000
  - Harta Topografike 1:25000 (2015)
  - Nomenklatura
- Rindërtimi i Informacioneve Kadastrale
  - RIK_2025
- Modeli Dixhital i Terrenit
  - Modeli Dixhital i Terrenit
- Rilevimi
  - Indexi i Ortofotove Rurale 2024
  - Indexi i Ortofotove Urbane 202
  - Indeksi i Ortofotove 2018
- Rrjeti Rrugor
  - Autostradë
  - Rrugë Nacionale
  - Rrugë Rajonale
- Njësi Administrative
  - Kufiri Shtetëror
  - Zonë urbane
- Njësitë Kadastrale
  - Zonat Kadastrale
  - Parcelat
  - Numri parcelës
  - Ndërtesat
  - Numri ndërtesës
- Sistemi i Adresave

KosovaRef01

Copyright © Agjencia Kadastrale e Kosovës

1018-0
1019-0
1020-0